

VENDIM
Nr.302, datë 28.4.2010

PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR RRAGAM-KAM-TROPOJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr. 9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, tokë bujqësore (pemëtore) dhe kultura, drufrutore, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rragam-Kam-Tropojë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 638 (gjashtëqind e tridhjetë e tetë) m², tokë bujqësore (pemëtore), si dhe kultura bujqësore drufrutore, me çmimet konfirmuar nga ZRKKP-ja, me vlerë 131 428 (njëqind e tridhjetë e një mijë e katërqind e njëzet e tetë) lekë, si dhe kultura bujqësore, me vlerë 110 000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 230 100 (dyqind e tridhjetë mijë e njëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për tokën bujqësore (pemëtore) dhe kulturat bujqësore, prej 241 428 (dyqind e dyzet e një mijë e katërqind e njëzet e tetë) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.5.2010 dhe të përfundojë më 1.8.2010.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MPPT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E NR. TË PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I AKSIT RRUGOR “RRAGAM-KAM” TROPOJË

Nr.	Pronari			Zona Kad.	Nr. Pas.	Sip.m ²	Çmimi lekë	Vlera lekë	Vlera për kultura bujqësore dhe dru frutorë	Lloji i pasurisë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Din	Sali	Qeleposhi	3490	747/2	158	206	32548		Pemëtore	Konfirmuar nga ZRPP
2	Dem	Sali	Qeleposhi	3490	747/3	148	206	30488		Pemëtore	Konfirmuar nga ZRPP
3	Rrustem	Bajram	Çelaj	3490	747/4	201	206	41406	110000	Pemëtore	Konfirmuar nga ZRPP
4	Hysni	Shefqet	Rrustaj	3490	645/1	90	206	18540		Pemëtore	Konfirmuar nga ZRPP
5	Hysni	Shefqet	Rrustaj	3490	645/2	41	206	8446		Pemëtore	Konfirmuar nga ZRPP
						638		131428	110000		
	Shuma								241428		

